

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme me të cilën kryesonte Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, më 21.05.2024, në bazë të nenit 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 96/19), neni 63 paragrafi (1) dhe (2), neni 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi Iniciativën për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor të paraqitur nga Mr. Oliver Gashev, avokat nga Velesi, të evidentuar nën Su-03.nr.177/23, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK PARIMOR

Gjykata e shkallës së dytë është kompetente të vendos për ankesë të deklaruar kundër vendimit të shkallës së parë në pjesën e vendimit për shpenzimet e bëra gjatë procedurës penale.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 nga Ligji për gjykatat, nga Mr. Oliver Gashev, avokat nga Velesi është paraqitur Iniciativë për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor lidhur me kompetencën për vendimmarrjen e ankesës së deklaruar kundër vendimit të shkallës së parë në pjesën e vendimit për shpenzimet e bëra gjatë procedurës penale. Në Iniciativën për miratim të qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor të paraqitur nga Mr. Oliver Gashev, avokat nga Velesi, janë parashtruar dy pyetje: 1. Kompetencë e kujt është që si shkallë e dytë të vendos për ankesë të aktgjykimit në pjesën e aktvendimit për shpenzimet e procedurës, gjykata e apelit apo këshilli penal i gjykatës themelore që ka vendosur në shkallën e parë, ndërsa është formuar sipas nenit 25 paragrafi (5) të Ligjit për procedurë penale? dhe 2. Cila gjykatë është kompetente që si shkallë e dytë të vendos për ankesë të aktvendimit për shpenzimet e procedurës të miratuar nga shkalla e parë, që ka vendosur në shkallën e parë, ndërsa e formuar sipas nenit 25 paragrafi (5) të Ligjit për procedurë penale?

Në fakt, me iniciativën tregohet për ekzistimin e një praktike ndryshe gjyqësore për sa i përket asaj se kompetencë e kujt është që të vendos për ankesë të aktgjykimit në pjesën e aktvendimit për shpenzimet e procedurës dhe për ankesë të aktvendimit për shpenzimet e procedurës, në mënyrë që janë bashkëlidhur edhe vendime konkrete gjyqësore. Ashtu që, për ankesën e deklaruar kundër aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës Themelore Kavadar, vetëm në pjesën e vendimit për shpenzimet e procedurës, ka vendosur Gjykata e Apelit Shkup, ndërsa në një lëndë tjetër në të njëjtën gjykatë themelore ka vendosur Këshilli penal i Gjykatës Themelore Kavadar. Gjithashtu për ankesë të aktvendimit për shpenzimet e procedurës të vendosur nga Gjykata Themelore Kavadar, ka vendosur Këshilli penal i Gjykatës Themelore

Kavadar, për derisa për ankesën e aktvendimit për shpenzimet e procedurës e vendosur nga Gjykata Themelore Veles, ka vendosur Gjykata e Apelit Shkup.

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 nga Ligji për gjykatat, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore mbi çështje të rëndësishme duke ofruar unitetin në zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej tre muajve, por jo më gjatë se gjashtë muaj me vetiniciativë ose me iniciativë të kryetarit të gjykatës apo me iniciativë të seancave të gjyqtarëve apo sektorëve gjyqësore nga gjykatat apo me iniciativë të avokatëve dhe i publikon në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Duke marrë parasysh sipër të theksuarën, dhe duke u udhëhequr nga dispozita e sipërcituar nga neni 37 paragrafi (1) nënpika 1 nga Ligji për gjykatat, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut vlerëson se ka zbatim jo të barabartë të ligjit, për këto arsye:

Në bazë të nenit 25 paragrafi (5) të Ligjit për procedurë penale, gjykatat e shkallës së parë, në këshillin e përbërë prej tre gjyqtarëve, vendosin për ankesa kundër vendimeve të gjykatësit të procedurës paraprake dhe kundër aktvendimeve të tjera kur kjo është e përcaktuar me ligj, miratojnë vendime në shkallë të parë jashtë seancës kryesore, miratojnë aktgjykim sipas dispozitave për zbatimin e aktgjykimit të huaj penal, të përcaktuara me ligj të posaçëm dhe paraqesin propozime në rastet e përcaktuara në këtë apo në ligj tjetër.

Në bazë të nenit 103 të Ligjit për procedurë penale, në çdo aktgjykim dhe aktvendim me të cilin ndërpritet procedura penale, do të vendoset se kush do t'i bart shpenzimet e procedurës dhe sa do të jenë ato.

Në bazë të nenit 104 të LPP, i akuzuari, i dëmtuari, paditësi privat, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor, i autorizuari, dëshmitari, eksperti, përkthyesi, interpretuesi dhe personi zyrtar, pa marrë parasysh rezultatin e procedurës penale, i bartin shpenzimet për sjelljen e tyre, për prolongimin e seancës kryesore dhe shpenzimet tjera të procedurës që i kanë bërë me fajin e vet.

Për shpenzimet nga paragrafi (1) i këtij neni miratohet aktvendim i posaçëm, përveç nëse për shpenzimet të cilat i bart paditësi privat dhe i akuzuari vendoset në vendimin për punën kryesore.

Për ankesën kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni vendos këshilli nga neni 25 paragrafi (5) i këtij ligji.

Duke i marrë parasysh dispozitat e sipërcituara, rezulton se këshilli nga neni 25 paragrafi (5) të Ligjit për procedurë penale është kompetent të vendos për ankesë kundër aktvendimit për shpenzimet e bëra me fajin e vet, përderisa për të njëjtat nuk është vendosur me vendimin e seancës kryesore. Ky është i vetmi rast kur miratohet aktvendim i posaçëm për shpenzimet. Në rastet tjera, aktgjykimi i miratuar, pavarësisht nga ajo se a është aktgjykim dënues, lirues apo refuzues apo aktvendim për ndërprerjen e procedurës penale, detyrueshëm përfshin vendim për shpenzimet e procedurës penale.

Nga këtu, duke qenë se Gjykata e Apelit është kompetente të vendos për ankesat kundër vendimeve të gjykatave themelore, në kuptim të nenit 33 të Ligjit për gjykatat, rezulton se për ankesë të deklaruar kundër vendimit të shkallës së parë në pjesën e vendimit për shpenzimet e bëra gjatë procedurës penale, kompetente për të vendosur është gjykata e shkallës së dytë.

Duke marrë parasysh të ekspozuarën më sipër, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për ofrimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga gjykatat dhe punën e gjykatave, e miratoi mendimin juridik parimor sipas të cilit gjykata e shkallës së dytë është kompetente të vendos për ankesë të deklaruar kundër vendimit të shkallës së parë në pjesën e vendimit për shpenzimet e bëra gjatë procedurës penale.

**SEANCA E PËRGJITHSHME E GJYKATËS SUPREME
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**